



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

2057  
22.04.2016

Nr. Rregj. Them. 6945/2405/388  
Dt. Regj. 09.09.2014

Nr. Vendimi 720  
Dt. Vendimi 06.04.2016

V E N D I M  
"Në emër të Republikës"

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë prej:

Kryesues: Kastriot SELITA  
Anëtare: Rilinda SELIMI  
Anëtare: Altina NASUFI

me sekretare gjyqësore **Mimoza Lazri**, në Tiranë, sot më datë 06.04.2016, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative nr. 6945/2405/388 akti, dt. Regjistrimi 09.09.2014 që u përket palëve ndërgjyqëse:

**PADITËS:** Shoqëria International Company sh.p.k me administrator Z. Qemal Muho, me NR NIPT L18810401T, me adrese Rruga Fier – Patos km 5, perball bar-restorant "Keshjtjella".

**E PADITUR:** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.

**PERSON I TRETË:** Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore Tirane.

**OBJEKTI:** 1. Konstatimin si absolutisht të pavleshëm të aktit administrativ Njoftim Vleresimi Nr.3904 prot, date 08.11.2012 (i ndryshuar) i D.R.T. Berat.  
2. Zgjidhjen e pasojave.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 31, 32, 324 të Kodit të Procedurës Civile, neni 116 i K.Pr. Administrative. Ligji Nr.7928, datë 27.4.1995 për "Tatimin mbi vlerën e shtuar", Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 për "Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) UDHËZIM Nr. 2, datë 30.1.2006 për "Procedurat tatimore" UDHËZIM Nr.24, datë 2.9.2008 për "Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Urdherit të Perbashket Nr.4288, date 30.04.2010 (F.Z. 90-2010) "Per kontrollin cilesor dhe sasior te ..." Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per QKR".

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me vendimin Nr. 722, dt 18.06.2013 ka vendosur:

1. Rrezimin e padise se paditesit, Shoqata "Internacional Kompany", si te pa bazuar ne ligje dhe ne prova.
2. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te paditesit sic jane bere.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlore, pala paditese Shoqeria International Company sh.p.k, me të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kerkese padise, për shkaqet:

- Me shkresen "Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" Nr.3904 date 08.11.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat ne dy kopje na eshte njoftuar nje detyrim ne shumen 13.006.109 leke per njerin kopje dhe 227.263 per kopjen tjeter, e cila eshte e pa drejte dhe per kete arsye ne i jemi drejtuar Drejtorise Apelimet Tatimore -Tirane brenda afatave te percaktura, e cila na ka kthyer pergjigje se nuk e ka marre parasysh per shkak se nuk eshte paguar detyrimi.
- Nga ana e DRT Berat eshte pretenduar se shitjet e perjashtuara te bera shoqerise Transoil Grup per Naften Bruto, nuk duhen trajtuar si te tilla (pra si shitje te perjashtuara), por ky pretendim i pales se paditur eshte i padrejte per arsyet qe do te shpjegojme me poshte.
- Nga pikpamja administrative D.P.T nuk ka asnje te drejte te zhvleresoje miratimin e dhene per kete lloj operacioni dhe nuk mund qe te zhvleresoje aktin administrative te nje organi tjeter, sic eshte rasti i AKBN e cila ka kompetenca ne te gjithë territorin e Republikës. DRT-Berat nuk mban parasysh edhe kerkesen e ligjit qe i jep te drejten vetem AKBN-s per te verifikuar dhe miratuar perjashtimin nga TVSH-ja. Me kete veprim ky organ merr dhe ushtron kompetenca qe nuk i ka, si dhe legjislacioni ne fuqi ja ka njohur vetem AKBN-se. Kjo agjensi ka specialist te fushes perkatese te cilet njohin jo vetem procesin teknologjik, por kane edhe te drejten ligjore per ushtrimin e kontrollit te procesit teknologjik qe sherben per shtimin e prodhimit, pra per zhvillimin ne sektorin e hidrokarbureve.
- Shoqeria Transoil Grup nuk ka blere naftë bruto nga shoqeria jone per ta trajtuar ate ne sektorin e shitjes edhe per faktin e njohur boterisht se kjo shoqeri operon ne nxjerrjen e naftes ne zonen naftembajtese Patos - Visoke. Pra ajo ka blere nga shoqeria jone nje produkt i cili injektohet ne shtrese per te rritur sasine e prodhimit te naftes, nepermjete proceseve teknologjike qe zhvillohen ne shtrese. Ky operacion eshte i domosdoshem per shtimin e prodhimit te naftes dhe eshte i aprovuar shkencerisht, teknologjikisht si i domosdoshem per zhvillimin e kesaj zone naftembajtese.
- Per perdorimin e holluesit ne shtrese ka edhe karta teknologjike te hartuar nga institutet tona shkencore ne sektorin e naftes. Kjo saktësohet edhe ne nenin 25 te ligjit Nr.7928, date 27.04.1995 "Per tatimin mbi vleren e shtuar" ne te cilin thuhet shprehimisht: "Janë të perjashtuara nga TVSH: a) Furnizimi i shërbimeve që kryhen nga kontraktorët e nënkontraktorët e tyre, vërtetuar si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure". Shprehja ne menyre eksplicite e ketij neni nuk le shteg per interpretim. Po keshtu edhe furnizimet qe jane bere per llogari te shoqerise tone me zerin "naftë bruto" e cila perdoret si hollues per shtresat naftë mbajtëse, eshte trajtuar nga ne si blerje e perjashtuar dhe per rrjedhoje nuk sjellim pasojë ne efektet financiare.
- Nese do te supozojme qe keto shitje do te behen me TVSh shoqerise Transoil Grup sha, atehere TVSH ne blerje duhet qe te na njihet edhe ne si shoqeri si TVSH e rimbursueshme, dhe nderkohe kjo sasi TVSH qe ne na kerkohet ne shitje do ti rimbursohet shoqerise "TRANSOIL" sha Grup dhe efekti financiar ne buxhetin e shtetit do te jete zero.
- Gjithashtu nga ana e DRT Berat eshte bere perlllogaritja e pa sakte per bazen e taksueshme, sepse nuk eshte marre ne konsiderat qe nese kjo do te trajtohet si produkt me TVSH, atehere baza e taksueshme duhet qe te llogaritet duke marre ne konsiderat qe cmimi ne shitje ka patur te perfshire edhe TVSH e blerjes si kosto e mallit.
- Cmimi mesatar i blerjes te llogaritur nga ana e juaj ka te pershire edhe 20% e TVSH-s i cili gjate kontabilizimit eshte shtuar ne vleren e mallit. Per ti qendruar korekt arsyetimit tuaj, nga pikpamja teknike ky cmim duhet qe te zhvishet nga vlera e TVSH.

- Per sa i perket pretendimit DRT Berat per problemin e 168 tone nafte bruto e cila mungon si gjendje inventari dhe pretendohet se eshte bere shitje pa u disponuar si mall, po ju paraqesin faturat e me poshteme, te cilat nuk jane perfshire ne librin e blerjes te muajit Shtator, por jane pasqyruar ne muajin tetor dhe konkretishte jane;

Blerjet e bera nga shoqeria A&A OIL 10 sha

NIPT L03408405S Fier

Nr	data	Nr.serise	Sasi	Cim \$	Leke	VL pa TVSH	TVSH	Totali
68	24.09.12	87529668	28.5	341.666	36917.01	1052134.8	210427	1262561.79
69	24.09.12	87529669	29.2	341.666	36917.01	1077976.7	215595	1293572.08
70	24.09.12	87529670	27.8	341.666	36917.01	1026292.9	205259	1231551.5
71	24.09.12	87529671	29.8	341.666	36917.01	1100126.9	220025	1320152.32
72	24.09.12	87529672	28.7	341.666	36917.01	1059518.2	211904	1271421.87
74	24.09.12	87529674	28.3	341.666	36917.01	1044751.4	208950	1253701.7
			172			6360801	1272160	7632961.26

- Per kete arsye vleresimi i bere nga DRT Berat per gjoben ne shumen 8.764.624 leke duhet te bjere.
- Pretendimi i DRT Berat per sasine e bitumit qe sipas tyre nuk eshte gjendje, nuk eshte e vertete sepse kjo sasi ka qene gjendje ne vendin e magazinimit dhe provohet me faturat e shitjes qe u jane bere subjekteve te ndryshme per kete produkt dhe per kete sasi.
- Pretendimi DRT Berat se shitja e solarit eshte bere nen kosto eshte i pa sakte, per sasine e shitur deri tani eshte shitur me cmimin e koston, por duke mare ne konsiderate se ka akoma sasi te ketij produkti qe do te shiten ne periudhen ne vazhdim dhe llogaritja behet me cmim mesatar ky problem mund te sjelle efekte pozitive deri ne fund te periudhes. Gjithashtu nga ana e juaj nuk eshte marre ne konsiderat edhe konjuktura e cmimeve gjate periudhes se shitjes se ketij produkti.
- Gjithashtu nga DRT Berat se kompania jonë ka marr paradhenie dhe nuk ka prere fature per paradheniet. Theksojme se ne nuk kemi kontrata me subjektet qe kane kaluar leket dhe nuk e kemi kerkuar nje gje te tille, dhe nuk kishim si te prisim fature.
- Per sa parashtroam me larte i kemi kerkuar DRT Berat anullimin e gjobes te nxjerre nga DRT Berat sepse akti administrativ i te cilit vjen ne kundershtin me nenin 116 te Kodit te Procedures Administrative te Republikes se Shqiperise, per mos njohjen e autorizimeve te leshuara nga AKBN per perjashtimin nga TVSH-ja, gje qe nuk eshte ne kompetencen e saj. Mos marrjen ne konsiderate te Faturave Tatimore te Shitjes per blerjen e 168 tone nafte bruto te cilat jane te pasqyruar ne muajin pasardhes.
- Duke qene se akti administrativ eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij, pasi te drejten e perjashtimit nga tvsh-ja per mallrat qe kjo firme furnizon e ka AKBN-ja dhe per rrjedhoje nuk eshte ne kompetencen e D.R.T.-Berat per te vendosur nese faturat tatimore te perjashtuara per pagimin e TVSH-se nga AKBN-ja jane te drejta apo jo, ky akt eshte nxjerre ne kundershtim me nenin 116/b te K.Pr.A dhe duhet te konstatohet si absolutisht i pavleshem. Duke qene se eshte akt absolutisht i pavleshem nuk eshte nevoja te ndiqen procedurat administrative sic kerkohet nga ligji, pasi konsiderohet nul dhe nuk ka sjell kurre pasojat.

- Pavleshmeria e ketij akti rezulton edhe persa i perket formes se nxjerrjes se tij i cili ne rastin konkret rezulton te paraqitet e njejta shkrese me te njejtin numer protokolli me dy permbajtje te ndryshme duke sjell si pasoje humbjen e individualitetit te shkrases zyrtare. Konkretisht akti administrativ Njoftim Vleresimi Tatimor me nr 3904 date 08.11.2012 rezulton ne dy forma njera me permbajtje detyrimi per shkak se 1-sipas sistemit informatik denim per pagese te vonuar dhe 2- detyrim bazuar ne raport -kontrollin nr 2406 dt 31.10.2012. Ne kete menyre aktit Njoftim Vleresimi Tatimor me nr 3904 date 08.11.2012 i eshte shkelur forma e tij dhe si pasoje duhet te deklarohet absolutisht i pavlefshem ne te dyja format e tij.
- Akti Njoftim Vleresimi Tatimor me nr 3904 date 08.11.2012 eshte absolutisht i pavleshem edhe per faktin se ne nxjerrjen e tyre eshte shkelur procedura dhe konkretisht prej pales se paditur nuk jane marre parasysht disa fatura tatimore me arsyetimin se sipas pohimit te tyre ne gjykate nuk kane qene ne momentin e dorezimit fillestar prej pales paditese por jane sjelle me vone. Duke qene se DRT Berat nepermjet inspektoreve te kontrollit kane shenuar faturen e fundit te marre prej kesaj firme per inspektim dhe faturat e tjera qe vertetojne pretendimet e pales paditese jane sjelle me vone atehere kjo drejtori nuk i ka marre parasysht. Kjo perben shkelje te K.Pr.Administrative dhe konkretisht te neneve 80 e vijues te K.Pr.A. Marrim rastin e nenit 85 te K.Pr.A. ku pales se interesuar i jepet afati per te paraqitur provat duke u pezulluar procedura per nxjerrjen e aktit (neni 85/3 i K.Pr.A). Edhe ne rastin se kjo pale nuk i sjell provat DRT Berat kishte detyrimin per ti kerkuar vete provat dhe faktet ne dhenien e vendimit perfundimtar bazuar ne nenin 85/2 te K.Pr.Administrative. Ne rastin konkret kjo pale jo vetem nuk na ka dhene kohen dhe as i ka siguruar vete keto fatura por edhe kur i kemi paraqitur ajo nxjerr pretendimin se mund te jene te bera me pas.
- Te gjitha keto fakte Gjykata e Rrethit Berat nuk na i ka marre parasysht ne kundershtrim me ligjin dhe me provat e administruara ne gjykim. Te gjitha keto rrethana jane shkaqe qe cojne ne pavleshmeri absolute te aktit administrativ dhe jo pavleshmeri relative sic arsyeton gjykata e rrethit Berat. Kjo gjykat nuk i ka dhene pergjigje te gjitha pretendimeve te ngritura prej nesh ne padine tone duke e bere vendimin te cenueshem edhe per kete fakt.
- Per arsyet e permendura me siper perfundimisht kerkoj prishjen e vendimit civil nr.722, dt 18.06.2013, te Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqesor Berat. Konstatimin si absolutisht te pavleshem te aktit administrativ Njoftim Vleresimi Nr.3904 prot date 08.11.2012 (i ndryshuar) i D.R.T. Berat ne te dyja format e tij.

Gjykata e Apelit Vlore, me vendimin Nr. 765 date 29.04.2014 ka vendosur  
*"Shpalljen e moskompetences lendore per shqyrtimin e çeshtjes civile Nr. 2456 regjistri, date 30.07.2013 regjistrimi. Dergimin e akteve gjykates kompetente, Gjykates se Apelit Administrativ Tirane".*

### Gjykata Administrative e Apelit;

Si u njoh me relatimin e gjyqtares Rilinda Selimi, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi çështjen ne tërësi;

### V Ë R E N

#### Rrethanat e ceshtjes;

Pala paditese shoqeria "International Company" sh.p.k ushtron veprimtarinë tregtare në fushen e

“Import-Eksport, tregetim me shumice dhe pakice i naftes bruto, Gazoil. Vajguri ndricues”. Shoqëria është regjistruar me emërtimin e mëparshëm tregtar “JON-MD” shpk me NIPT L18810401T me adresë rruga nacionale Fier - Patos, kilometri i peste perballe bar- restorant “Keshjtjella”, Patos, Fier.

Rezulton se ndaj shoqërisë është ushtruar kontroll nga ana e Inspektoreve të Drejtorise Rajonale te Tatimeve Berat, në baze te “Autorizim per kryerje kontrolli” Nr, 2166 prot. date 28.09.2012, “Njoftim per kontrolli” Nr. 2166/1 prot. date 28.09.2012, dhe “Program Kontrolli” Nr.2166/2 Prot., date 28.09.2012.

Kontrolli ka pasur objekt:

1- Kontroll per tatim fitimin viti 2011.

2- Kontroll per Tvsh-e per periudhen Shkurt 2011 – Shtator 2012.

3- Kontrolli per Sigurimet Shoqerore dhe Shendetesore per periudhen Shkurt 2011- Shtator 2012.

Gjate ketij kontrolli rezultoi se paditesi gjate vitit 2011 ka furnizuar me nafte bruto, per sasine prej 674580 dhe vleren 57339300 leke, shitje keto qe i jane bere shoqerise “Transoil Group” sha, Tirane, me nipt L11725004T. Kjo shoqeri ushtron aktivitetin për zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve sidomos i burimeve të naftës si dhe rafinimin e përpunimin e tyre etj. Shoqëria është dhe operatori për zhvillimin e marrëveshjes hidrokarbure datë 03.12.2008 në vendburimin e Visokës të lidhur me qeverinë shqiptare.

Në referencë të Ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”, neni 25/1 dhe Udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”, pika 8/7, përcaktohet se kontraktorët dhe nënkontraktorët që përfitojnë nga përjashtimet nga skema e TVSh janë ato tatimpagues të TVSH-së që kryejnë në emër të tyre vetëm furnizimet specifike të shërbimeve të përmendura në përcaktimet “kërkim” dhe “zhvillim” të Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet”.

Në bazë të ketij kuadri ligjor, përfitimi I këtij përjashtimi shtrihet për ato shërbime të ofruara kontraktorëve të cilat janë vërtetuar dhe certifikuar nga AKBN me autorizimet përkatëse.

Mosmarrëveshja objekt gjykimi ka shkak pikërisht vlerësimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat se në të kundërt sa është deklaruar nga paditësi furnizimet e faturuara shoqërisë kontraktore “Transoil Group” sha, Tirane nuk konsiderohen shitje të përjashtuara nga tvsh.

Autorizimi I pretenduar nga paditësi është lëshuar nga AKBN pasi janë kryer transaksionet. Transaksionet e kryera nga paditësi në atë periudhë me emrin e mëparshëm tregtar për shitje naftë bruto shoqërisë “Transoil Group” shpk janë kryer në muajin maj dhe qershor 2012 ndërsa shoqëria është pajisur me vërtetim nga AKBN në fund të muajit shtator 2012.

Ne kushtet kur paditesi nuk ka paguar TVSH per shitjet e mesiperme, organet tatimore e kane konsideruar kete shkelje me pasoje njoftimin e detyrimeve te vlerësuara për periudhen maj 2012 dhe shtator 2012 dhe penalitetin përkatës me aktin, njoftim vlerësimi tatimor Nr. 3904 date 08.11.2012 me vlere totale detyrimi 28 538 281 leke. Sa më sipër vlerësuar referon ne planin e masave nxjerre nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nr. 17186/1 prot. Datë 01.08.2012 “Për menaxhimin e problematikës se tvsh-se në furnizimin e shërbimeve ndaj shoqërive që kanë marrëveshje hidrokarbure me qeverinë shqiptare”, pika 6 për rastet kur subjektet janë të pajisura me autorizim nga AKBN, sipas se ciles Drejtoria Rajonale Tatimore nuk do te njohe autorizimet apo veretimet e lëshuara nga AKBN në të gjitha ato raste kur autorizimi apo vërtetimi është lëshuar pas momentit të kryerjes së shërbimit.

Paditesi ka ankimuar këtë akt prane Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane, por ne kushtet e mosparapagimit të detyrimeve Drejtoria e Apelimit Tatimor ka vendosur refuzimin për shqyrtim të ankimit.

Në këto rrethana është depozituar pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Berat padia objekt gjykimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të njoftim vlerësimit tatimor Nr. 3904 date 08.11.2012 të nxjerë nga i padituri. Në këtë gjykim është thirrur kryesisht si person I tretë Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore Tirane.

Paditësi ka kërkuar pranimin e padisë me pretendimet se:

- DRT-Berat nuk mban parasysh kërkesen e ligjit që i jep te drejten vetem AKBN-s për te verifikuar dhe miratuar përjashtimin nga TVSH-ja. Me kete veprim ky organ merr dhe ushtron kompetenca që nuk i ka, si dhe legjislacioni ne fuqi ja ka njohur vetem AKBN-se. Kjo agjensi ka specialist te fushes perkatese te cilet njohin jo vetem procesin teknologjik, por kane edhe te drejten ligjore per ushtrimin e kontrollit te procesit teknologjik qe sherben per shtimin e prodhimit, pra per zhvillimin ne sektorin e hidrokarbureve.
- Shoqeria Transoil Grup nuk ka blere nafte bruto nga shoqeria e jone per ta trajtuar ate ne sektorin e shitjes, por nje produkt i cili injektohet ne shtrese per te rritur sasine e prodhimit te naftes, nepermjete proceseve teknologjike qe zhvillohen ne shtrese. Ky operacion eshte i domosdoshem per shtimin e prodhimit te naftes dhe eshte i aprovuar shkencërisht, teknologjikisht si i domosdoshem per zhvillimin e kesaj zone naftembajtese.
- Per perdorimin e holluesit ne shtrese ka edhe karta teknologjike te hartuar nga institutet tona shkencore ne sektorin e naftes. Kjo saktësohet edhe ne nenin 25 te ligjit Nr.7928, date 27.04.1995 "Per tatimin mbi vleren e shtuar" ne te cilin thuhet shprehimisht: "Janë të përjashtuara nga TVSH: a) Furnizimi i shërbimeve që kryhen nga kontraktorët e nënkontraktorët e tyre, vërtetuar si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure".
- Po keshtu edhe furnizimet qe jane bere per llogari te shoqerise tone me zerin "nafte bruto" e cila perdoret si hollues per shtresat nafte mbajtese, eshte trajtuar nga ne si blerje e përjashtuar dhe per rrjedhoje nuk sjellim pasoje ne efektet financiare.
- Nese do te supozojme qe keto shitje do te behen me TVSh shoqerise Transoil Grup sha, atehere TVSH ne Blerje duhet qe te na njihet edhe ne si shoqeri si TVSH e rimbursueshme, dhe nderkohe kjo sasi TVSH qe ne na kerkohet ne shitje do ti rimbursohet shoqerise "TRANSOIL" sha Grup dhe efekti financiare ne buxhetin e shtetit do te jete zero.
- Gjithashtu nga ana e DRT Berat eshte bere perllogaritja e pa sakte per bazen e taksueshme, sepse nuk eshte marre ne konsiderat qe nese kjo do te trajtohet si produkt me TVSH, atehere baza e taksueshme duhet qe te llogaritet duke mare ne konsiderate qe cmimi ne shitje ka patur te perfshire edhe TVSH e blerjes si kosto e mallit.
- Cmimi mesatar i blerjes i llogaritur nga DRT Berat ka te pershire edhe 20% e TVSH-s i cili gjate kontabilizimit eshte shtuar ne vleren e mallit. Nga pikpamja teknike ky cmim duhet qe te zhvishet nga vlere e TVSh.
- Per sa i perket pretendimit DRT Berat per problemin e 168 tone nafte bruto e cila mungon si gjendje inventari dhe pretendohet se eshte bere shitje pa u disponuar si mall, disponojmë faturat te cilat nuk jane perfshire ne librin e blerjes te muajit Shtator, por jane pasqyruar ne muajin tetor. Per kete arsye vleresimi i bere nga DRT Berat per gjoben ne Shumen 8.764.624 leke duhet te bjere.

Tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar dhe akteve nenligjore nxjerre ne zbatim te tij. Kolegji Administrativ i Apelit, ne te kundërt sa parashtrohet nga paditesi, cmon se nuk jemi perpara ndonje shkakut te pavlefshmerise absolute te aktit administrativ përcaktuar ne nenin 116 te K.Pr.Administrative.

Ne kete dispozite parashikohet se:

*“Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme në kuptim të këtij Kodi në rastet e mëposhtme:*

- a) Kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar.*
- b) Kur akti administrativ është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore.*
- c) Kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën ose procedurën e kërkuar nga ligji”.*

Ne përputhje me përcaktimet ligjore te ketij Kreu, provohet nga provat e administruara ne gjykim se kontrolli eshte ushtruar sipas procedures paraprake per kryerjen e tij. Keshtu, ne përputhje me nenin 80 te ligjit, rezulton se per kryerjen e ketij kontrolli shoqëria paditese eshte njoftuar me shkresen nr. “Njoftim per kontroll” Nr. 2166/1 prot. date 28.09.2012. Ky njoftim eshte nxjerre sipas autorizimit per kryerjen e kontrollit Nr. 2166 prot. date 28.09.2012, dhe program kontrollit miratuar nga titullari i DRT Berat, sipas te cilit shoqëria do kontrollohej per tatim fitimin viti 2011, dhe tatimin mbi vleren e shtuar dhe sigurime shoqerore dhe shendetsore per periudhen Shkurt 2011 – Shtator 2012.

Kolegji Administrativ i Apelit, cmon se procedura per nxjerrjen e ketij akti ka garantuar kryerjen e kontrollit me miratim te titullarit, nga inspektori i autorizuar dhe sipas programit te miratuar, duke garantuar njoftimin dhe te drejten e shoqerise tatimpaguese te parashtroje qëndrimin e saj dhe kundërshtimet perkatese lidhur me perfundimet e kontrollit, cka ne rast te kundërt, do të përbente cënim të procesit të rregullt ligjor.

Kolegji Administrativ i Apelit cmon vendimin e dhene ne cilesim te drejtë te kerkimit objekt padie ne veshtrim te ligjeve te posacme qe lidhen me perjashtimin nga pagimi i tvsh, autoritetet kompetente dhe rregullat per leshimin e autorizimit.

Në referencë të Ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”, neni 25/1 dhe Udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”, pika 8/7, ku thuhet se operacionet hidrokarbure për efekt të këtij paragrafi kanë të njëjtin kuptim me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet”, kontraktorët dhe nënkontraktorët që përfitojnë nga përjashtimet e mësipërme janë ato tatimpagues të TVSH-së që kryejnë në emër të tyre vetëm furnizimet specifike të shërbimeve të përmendura në përcaktimet “kërkim” dhe “zhvillim” të Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet”. Sipas paragrafit 8.7 “Kontraktorët dhe nënkontraktorët që përfitojnë nga përjashtimet e mësipërme janë ato tatimpagues të TVSH, që kryejnë në emër të tyre vetëm furnizimet specifike të shërbimeve të përmendura në përcaktimet “Kërkim” dhe “Zhvillim”, të Ligjit nr 7746 dt 28.07.1993”Për Hidrokarburet”.

Përkufizimi i termave “kërkim” dhe “zhvillim”, gjendet në Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)”, neni 2, terma të cilat janë huazuar dhe në Udhëzimin nr. 17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”, ku citojmë: “Kërkim “do të thotë kërkimi për hidrokarbure me mjete gjeologjike, gjeofizike e të tjera, dhe përfshin shpimin e puseve të kërkimit dhe vlerësimit. “Zhvillim” do të thotë ndërtimi dhe instalimi i pajisjeve për prodhimin e Hidrokarbureve dhe shpimi i puseve të shfrytëzimit”

- Pretendimi i DRT Berat per sasine e bitumit qe sipas tyre nuk eshte gjendje, nuk eshte vertetë sepse kjo sasi ka qene gjendje ne vendin e magazinimit dhe provohet me faturat e shitjes qe u jane bere subjektje te ndryshme per kete produkt dhe per kete sasi.
- Pretendimi DRT Berat se shitja e solarit eshte bere nën kosto eshte i pa sakte, per sasine e shitur deri tani eshte shitur me cmimin e koston, por duke mare ne konsiderate se ka akoma sasi te ketij produkti qe do te shiten ne periudhen ne vazhdim dhe llogaritja behet me cmim mesatar ky problem mund te sjelli efekte pozitive deri ne fund te periudhes . Gjithashtu nuk eshte mare ne konsiderat edhe konjuktura e cmimeve gjate periudhes se shitjes se ketije produkti.

Pretendimet si më sipër paditësi i ka parashtruar edhe ne ankim administrativ. Sipas paditësit akti administrativ është nxjerrë ne kundërshtin me nenin 116 te Kodit te Procedurave Administrative te Republikës se Shqipërisë pasi është rrjedhojë e mosnjohjes nga administrata tatimore e autorizimeve te leshuara nga AKBN per perjashtimin nga TVSH-ja, në tejkalim ne kompetencave e saj si dhe rrjedhojë e moskonsiderimit te Faturave Tatimore te Shitjes per blerjen e 168 tone Naftë bruto te cilat jane te pasqyruar ne muajin pasardhes.

Pala paditëse ka pretenduar gjithashtu se:

- pavleshmeria e ketij akti rezulton edhe persa i perket formes se nxjerrjes se tij i cili ne rastin konkret rezulton te paraqitet e njejtë shkresë me te njejtin numer protokolli me dy permbajtje te ndryshme duke sjell si pasoj humbjen e individualitetit te shkrësës zyrtare. Konkretisht akti administrativ Njoftim Vlerësimi Tatimor me nr 3904 date 08.11.2012 rezulton ne dy forma njera me permbajtje detyrimi per shkak se 1-sipas sistemit informatik denim per pagese te vonuar dhe 2- detyrim bazuar ne raport -kontrollin nr 2406 dt 31.10.2012.
- në nxjerrjen e tij eshte shkelur procedura dhe konkretisht prej pales se paditur nuk jane marre parasysh disa fatura tatimore me arsyetimin se sipas pohimit te tyre ne gjykate nuk kane qene ne momentin e dorezimit fillestar prej pales paditese por jane sjelle me vone. Duke qene se DRT-Berat nepermjet inspektoreve te kontrollit kane shenuar faturen e fundit te marre prej kesaj firme per inspektim dhe faturat e tjera qe vertetojne pretendimet e pales paditese jane sjelle me vone atehere kjo drejtori nuk i ka marre parasysh.

Objekti i ketij procesi eshte shqyrtimi i ligjshmerise se vendimit Nr. 722, dt 18.06.2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Berat per rrezimin e padise duke vlerësuar te drejte e te bazuar prapesimet e administrates tatimore pale e paditur. Ankimi i shoqerise paditese nuk eshte shqyrtuar ne themel nga Gjykata e Apelit Vlore e cila me vendimin Nr. 765 date 29.04.2014 ka derguar ceshtjen per kompetence gjykimi Gjykates Administrative te Apelit si mosmarreveshje administrative lindur midis paditesit tatimpagues dhe administrates tatimore, Drejtoria Rajonale Tatimore.

**Kolegji Administrativ i Apelit cmon se ankimi i palës paditësi nuk përmban shkaqe ligjore per cenimin e vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Berat, ndaj ky vendim duhet të lihet në fuqi.**

Kolegji Administrativ i Apelit cmon te drejte perfundimin e gjykates se njoftim vlerësimi tatimor Nr. 3904 prot date 08.11.2012 eshte nxjerre ne përputhje me ligjin nga organi kompetent, ne përfundim te procedurave tatimore sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920/2008 "Per procedurat

Gjithashtu, në këtë udhëzim përcaktohen dhe kategoritë e nënkontraktorëve që nuk e përfitojnë këtë përjashtim për furnizimet e tyre, ku përfshihen "...nënkontraktorët që furnizojnë shërbime që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fazat e kërkimit dhe të zhvillimit, si shërbime interneti, telefonike, akomodimi, etj". Në rastin në shqyrtim DRT Berat ka konstatuar me të drejtë se transaksioni i realizuar nga paditësi është furnizim malli dhe jo shërbimi.

Pretendimi i paditësit se AKBN gezon cilesine e te vetmit organ kompetent dhe se nuk ka asnje organ tjetër që te interpretoje ne lidhje me perjashtimin ose jo nga detyrimet tatimore dhe doganore që lidhen me furnizimin e mallrave per operacionet hidrokarbure eshte ne kundërshtim me ligjin.

Dispozita që citon pala paditese percakton qarte se Kontraktorët dhe nënkontraktorët vërtetohen si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Pra AKBN vetem verteton cilesine e subjektit si kontraktor apo nenkontraktor per realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure. Sa me siper, rezulton edhe nga gama e kompetencave te saj sipas aktit te krijimit, VKM nr. 574 date 09.08.2006.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat cilëson drejt se *njoftim vlerësimi tatimor nr. 3904 prot. Datë 08.11.2012 eshte nxjere nga organi tatimor, i padituri DRT Berat në ushtrim të funksionit dhe përgjegjësi të tij ligjore ngarkuar nga Ligji 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", për mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit fiscal tatimor, vlerësimin dhe mbledhjen e tyre.*

*Nxjerrja e aktit I atribuohet këtyre organeve dhe është në kompetencën e tyre ligjore.* Pretendimi i paditësit se AKBN gezon cilesine e te vetmit organ kompetent dhe se nuk ka asnje organ tjetër që te interpretoje ne lidhje me perjashtimin ose jo nga detyrimet tatimore (dhe doganore) që lidhen me furnizimin e shërbimeve per operacionet hidrokarbure eshte ne kundërshtim me ligjin.

Dispozita që citon pala paditese percakton qarte se Kontraktorët dhe nënkontraktorët vërtetohen si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Pra AKBN vetem verteton cilesine e subjektit si kontraktor apo nenkontraktor per realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure për furnizimet specifike të rregulluara nga ligji. Sa me siper, rezulton edhe nga gama e kompetencave te saj sipas aktit te krijimit, VKM nr. 574 date 09.08.2006.

Sa i takon pretendimeve te tjera te paditesit te shprehura edhe në ankim lidhur me llogaritje të pasaktë të bazës së taksueshme, referencat në cmim, konsiderimi i faturave të pasqyruara në muajin pasardhës, lëshimi I faturave, gjendja në inventar etj, Kolegji vlereson te bazuar arsyetimin e gjykates se shkalles se reklamojnë shkaqe të pavlefshmërisë relative të aktit të cilat nuk mund të merren në shqyrtim.

Ne përfundim te sa me sipër Kolegji Administrativ i Apelit konkludon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat duhet te lihet ne fuqi per te gjitha ato rrethana dhe fakte që u permenden me siper.

#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur ne nenin 50, germa "b" te Ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative"

## VENDOSI

1. Lënien ne fuqi te vendimit Nr. 722, dt 18.06.2013 të Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Berat.
2. Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të tij.

U shpall në Tiranë, sot më 06.04.2016.

**ANËTARE**  
Altina NASUFI  
(D.V)

**ANËTARE**  
Rilinda SELIMI  
(D.V)

**KRYESUES**  
Kastriot SELITA  
(D.V)

E njesuar me origjinalin

*Kancelari*  
*Leonard Shani*  
*Shani*